

L I G J
Nr.8247, datë 2.10.1997

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8152, DATË 12.9.1996

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", neni 3 ndryshohet si vijon:

"Mallrat e veçanta që tatohen me akcizë, përqindjet e tyre dhe vlera e akcizës për një pullë janë:

	Përqindja e akcizës	Vlera e akcizës për një pullë
A. DUHAN E PRODHIME DUHANI		
- duhan për konsum		
- vendi	70	
- importi	105	
- cigare		
- kategoria I importi		45 lekë/paketa
- kategoria II importi		25 lekë/paketa
- kategoria III importi		18 lekë/paketa
- kategoria III vendi		9 lekë/paketa
- puro importi		2240 lekë/kg
B. PIJE ALKOOLIKE		
- birrë		
- vendi	40	
- importi	65	
- verë		
- vendi		40 lekë/litri
- importi		50 lekë/litri
- raki		
- vendi		90 lekë/litri
- importi		115 lekë/litri
- konjak, uzo, fërnet, ponç, uiski, rum, likerna dhe të gjitha pijet e tjera alkoolike		

- vendi	90 lekë/litri
- importi	150 lekë/litri

C. PIJE JOALKOOLIKE, FRESKUESE E TE TJERA

- vendi	5
- importi	30

Ç UJE MINERAL DHE I GAZUAR

- vendi	-
- importi	20

D. KAFE

30

Përqindja
e akcizës

Vlera e akcizës
për një pullë

DH. NENPRODUKTET E NAFTES

- benzinë deri 75 oktan vendi	15
- benzinë 75.1-89.9 oktan vendi	47
- benzinë 89.9 oktan importi	60
- benzinë 90 oktan e lart importi	50
- gazoil	
- vendi	20
- importi	40
- valvolinë	80
- vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe graso	
- vendi	40
- importi	80
- të tjera (solar, mazut, koks naftë, bitum, gaz i lëngët, toluol, squfur, ksilol, solvent)	25

Importimi i çdo lloj nënprodukti naftë që nuk përfshihet në shkronjën "dh", përveç vajgurit, do të trajtohet me akcizë 300 përqind.

Përfshihen nga akciza gaz i lëngët i importit për përdorim në popullsi si dhe mazuti e solari të prodhuara në vend që përdoren për prodhim avulli për ngrohjen e popullsisë.

Merret në formë akcize edhe diferenca ndërmjet çmimit përfundimtar të shitjes dhe çmimit të caktuar nga organet shtetërore, duke i shtuar këtij të fundit për nënproduktet e naftës përqindjet e caktuara në shkronjën "dh" të këtij neni dhe taksën e qarkullimit rrugor për benzinën dhe gazoilin.

Këshilli i Ministrave ka autoritetin të caktojë diferenca çmimi për gazoilin dhe benzinën e importuar."

Neni 2

Për cigaret, purot dhe pijet alkoolike të importuara dhe të prodhuara në vend akciza do të

paguhet me blerjen e pullës.

Personave juridikë e fizikë vendas e të huaj që prodhojnë pije alkoolike dhe cigare për eksport, vlera e akcizës së paguar me blerjen e pullës do t'u rimbursohet me paraqitjen e dokumenteve të eksportit të doganës.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të marrin masa për prodhimin e pullave për artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike.

Neni 4

Në ligjin nr. 7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 4, paragrafi i parë, rreshti i parë, pas fjalës "vendit" shtohen fjalët ", përveç mallrave, akciza e të cilave paguhet me blerjen e pullës".

2. Në nenin 5, rreshti i dytë, pas fjalës "doganore" shtohen fjalët ", përveç mallrave, akciza e të cilave paguhet me blerjen e pullës".

3. Në nenin 7, rreshti i dytë, pas fjalës "doganore" shtohen fjalët ", përveç mallrave, akciza e të cilave paguhet me blerjen e pullës".

Neni 5

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij ligji.

Neni 6

Ligji nr.8152, datë 12.9.1996 shfuqizohet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më datën 15.10.1997.